

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A- 025/14

Prishtinë,
4 nëntor 2015

Në çështjen juridike të:

S.S.V.

Brestovačka 30
11406 Kovačevac
Mladenovac BG
Serbi

Pala ankuese/Paraqitësi i kërkesës

Kolegji i Apelit i AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit, Rolandus Bruin dhe Krassimir Mazgalov, anëtarë, duke vendosur me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/C/200/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA 28181), të datës 18 prill 2013, pas shqyrtimit të mbajtur më 4 nëntor 2015, mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e palës ankuese kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/C/200/2013, e datës 18prill 2013.
2. Vërtetohet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPPC/D/C/200/2013, i datës 18 prill 2013, lidhur me kërkesën e regjistruar në AKP me numrin KPA28181.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 1 mars 2007, S.S.V. (më tutje: Paraqitësi i kërkesës) ka paraqitur një kërkesë duke kërkuar vërtetimin e të drejtës së pronësisë dhe ri-posedimin e një shitoreje me sipërfaqe prej 12 m² (më tej: prona e kërkuar), që ndodhet në rrugën “Lepenačka”, numër 6, Zona Kadastrale e Kaçanikut, në Kaçanik.
2. Për ta mbështetur kërkesën e tij, paraqitësi i kërkesës i dorëzoi këto dokumente:
 - Kërkesën bërë Komunës së Kaçanikut, të datës 14 korrik 1997. Me këtë dokument, paraqitësi i kërkesës kërkoj nga Komuna një leje për ta shfrytëzuar pronën e kërkuar për të shitur gjëra të vogla;
 - Kontratën e blerjes nr. 01-192-361/1, e datës 11 gusht 1977, lidhur me pronën e kërkuar, e lidhur ndërmjet paraqitësit të kërkesës dhe Komunës së Kaçanikut – Drejtoria për Tokë Ndërtimore Urbane;
 - Një kopje të ofertës për renovim të pronës komerciale që ndodhet në ndërtesën e ish-Komitetit në Kaçanik. Dokumenti thekson shprehimisht nëse oferta e renovimit është për pronën e kërkuar; dhe
 - Kopjen e letërnjoftimit të paraqitësit të kërkesës nr. 1210968960014, të datës 7 qershor 2006.
3. Raportet verifikuese të AKP-së, të datës 3 shtator 2008, të bëra në Departamentin e Kadastrit dhe 7 shkurt 2012, të bëra në organet e Admnittraës Publike në Beograd, konstatojnë se kontrata e blerjes e dorëzuar nga paraqitësi i kërkesës nuk ka mundur të verifikohet pozitivisht.
4. Me datën 25 korrik 2008, uzurpuesi L.D. a i cili ka qenë i pranishëm gjatë njoftimit është njoftuar në lidhje me kërkesën. Gjatë njoftimit, L.D. nuk ka kërkuar ndonjë të drejtë ligjore mbi pronën e kërkuar.
5. Më 18 prill 2013, KKPK-ja me Vendimin e vet KPCC/D/C/200/2013 e ka refuzuar kërkesën duke pasur parasysh se paraqitësi i kërkesës nuk ka arritur të tregojë pronësinë apo ndonjë të drejtë tjetër pronësore mbi pronën e kërkuar menjëherë para apo gjatë konfliktit të viteve 1998/1999.
6. Vendimi i KKPK-së i është dorëzuar paraqitësit të kërkesës (më tej: pala ankuese) më 6 gusht 2013. Ai dorëzoi ankesë kundër vendimit më 2 shtator 2013.

Pretendimet e palës ankuese:

7. Pala ankuese pohon se vendimi i KKPK-së është i bazuar në vërtetimin e gabuar dhe të mangët të fakteve dhe në zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

8. Pala ankuese thekson se arsyetimi i vendimit të KKPK-së se Sekretaria Ekzekutive të AKP-së nuk ka qenë në gjendje t'i vërtetojë ndonjërin prej dokumenteve që i janë bashkëngjitur kërkesës është i pasaktë. Sipas palës ankuese, autoritetet kompetente para të cilave është dashur të kryhet verifikimi ekzistojnë. Ata i kanë regjistruar e tyre në bazë të të cilave mund të konfirmohet se dokumentet e paraqitura janë të vërteta. Për më tepër, pala ankuese pretendon se “shënimi arbitrar” i KKPK-së se Sekretaria Ekzekutive nuk ka qenë në gjendje t'i verifikojë ndonjërin nga dokumentet e dorëzuara si të vërteta, pa i specifikuar raportet e verifikimit, nuk është i pranueshëm.
9. Pala ankuese pretendon se ai e ka fituar të drejtën e pronësisë mbi pronën e kërkuar më 11 gusht 1997, përmes kontratës së blerjes (Kontrata e blerjes nr. 01-192-361/1, e datës 11 gusht 2007) e lidhur me Komunën e Kaçanikut – Drejtoria për Tokë Ndërtimore Urbane. Ai e ka shfrytëzuar këtë deri në qershor 1999, kur ishte detyruar të largohet nga Kosova. Prandaj, bazuar në këtë, pala ankuese pretendon se është vërtetuar pa dyshim se ai është pronar dhe posedues ligjor i pronës së kërkuar.
10. Pala ankuese i propozon Gjykatës Supreme të Kosovës që ta aprovojë ankesën e tij dhe të merr vendim me të cilin do të konfirmohet se ai ka të drejtë në ri-posedimin e pronës së kërkuar.

Arsyetimi ligjor:

Pranueshmëria e ankesës:

11. Ankesa është e pranueshme. Është paraqitur brenda periudhës prej 30 ditësh sikurse parashihet me nenin 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079, për zgjidhjen e kërkesave që ndërlidhen me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale (më tej: Ligji nr. 03/L-079).

Meritat e ankesës:

12. Sidoqëtëjetë, ankesa është e pabazuar. Sipas nenit 3.1 të Ligjit nr. 03/L-079, paraqitës i kërkesës ka të drejtë në një urdhër nga KPCC për ri-posedimin e pronës nëse paraqitësi i kërkesës jo vetëm **dëshmon pronësinë e pronës së paluajtshme private**, por edhe se ai apo jo nuk është në gjendje t'i ushtrojë ato të drejta pronësore për shkak të rrethanave që ndërlidhen drejtpërdrejtë apo rezultojnë nga konflikti i armatosur që ndodhi në Kosovë në periudhën ndërmjet 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.
13. KKPK-ja e ka bazuar vendimin e vet në faktin se AKP kishin bërë një verifikim negativ në dokumentet në të cilat pala ankuese e bazon kërkesën e tij, përfshirë kontratën e blerjes nr. 01-192-361/1, të datës 11 gusht 1997. KKPK-ja nuk kishte qenë në gjendje të sigurojë *ex officio*

ndonjë provë që mbështet kërkesën e palës ankuese. Bazuar në këtë, KKPK-ja konstatoi se pala ankuese nuk ka arritur të vërtetojë ndonjë të drejtë pronësore mbi pronën e kërkuar.

14. Ankesa e palës ankuese i përsërit pretendimet e njëjta që ai i kishte bërë para KKPK-së. Nuk është paraqitur ndonjë provë e re e rëndësishme së bashku me ankesën.
15. Gjykata Supreme konsideron se nuk qëndron pretendimi i palës ankuese se verifikimi i dokumenteve të dorëzuara si të vërteta nuk është bërë në regjistrat e organeve relevante ekzistuese. Nga raportet verifikuese të AKP-së të datave 3 shtator 2008 dhe 7 shkurt 2012, mund të shihen se AKP-ja kishte bërë përpjekje të arsyeshme që t'i verifikojë dokumentet e përmendura në regjistrat e institucioneve përbrenda territorit të Kosovës, por gjithashtu në regjistrat e institucioneve të Serbisë (Organet Publike dhe Administrative).
16. Gjykata Supreme konstaton se KKPK-ja ka marrë vendim të drejtë, të bazuar në procedurë tërësore dhe të saktë. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme konstaton se nuk ka pasur shkelje të së drejtës materiale apo vërtetim të mangët të fakteve, siç pretendon pala ankuese në ankesën e tij. Gjykata Supreme konstaton se ankesa është e pabazuar.
17. Nga arsyet e paraqitura dhe në përputhje me nenin 13.3 nën (c) të Ligjit 03/L-079, është vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Këshillë ligjore

Në përputhje me nenin 13.6 të Ligjit 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetar i Kolegjit

Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it

Rolandus Bruin, Gjyqtar i EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it